



Mali i Zi / Crna Gora
Komuna e Tuzit / Opština Tuzi

Kryetari i Komunës
Predsjednik Opštine

Nr./Br. 04-633/24-2970/2

Rruga Tuz nr. 1 , nr. 44
Ulica Tuzi br.1 , br. 44

+382 20 875 167

kryetari@tuzi.org.me

Tuz – Tuzi, 09.05.2024. godine

Në bazë të nenit 26 paragrafit 1 të Vendimit mbi organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit („Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale“ nr 043/20 dhe 43/23) e në lidhje me nenin 10 Paragraf 3 i Vendimit mbi bashkëfinancimin e projekteve nga fusha e kulturës („Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale“, nr 047/22 prej më 04.10.2022), Komisionit për ndarjen e mjeteve në bazë të konkursit për bashkëfinancim të projekteve nga fusha e kulturës në seancën e mbajtur më 17.04.2024. solli:

Propozim Vendimi

Për ndarjen e mjeteve në bazë të konkursit për bashkëfinancim të projekteve nga fusha e kulturës për vitin 2024.

I

Komisioni për ndarjen e mjeteve në bazë të konkursit për bashkëfinancimin e projekteve në fushën e kulturës për vitin 2024 propozoi që mjetet për bashkëfinancimin e projekteve të shpërndahen si më poshtë:

Emri dhe mbiemri	Fusha konkurente	Emri i projektit	Shuma
1. Samir Bečaj	Veprimtari muzikore dhe skeniko-muzikore	CD me këngë burimore shqipe dhe instrumental pjesa e III	1.000,00€
2. Kristjan Dukaj	Përkthim letrar	Përkthimi i romanit “Besa-përjetësisht” – në gjuhën malazeze	600,00€
3. Arlinda Dushaj	Aktivitetet publike	“Misticizmi që të magjeps”	1.500,00€
4. Monika Dukaj	Artet e bukura dhe aktivitetet ekspozuese	Promovimi dhe ruajtja e trashigimisë kulturore dhe historike përmes artit pamor	600,00
Shuma totale			3.700,00€

II

Pjesëmarrësi i konkursit që nuk i plotëson kushtet për bashkëfinancimin e projektiteve në fushën e kulturës për vitin 2024:

Emri dhe mbiemri	Fusha konkurente	Emri i projektit	Shuma
1. Veronika Dedvukaj	Aktivitetet publike	Botimi i librit “The Loss”	/

Arsyetim

Neni 9 i Vendimit për bashkëfinancimin e projekteve në fushen e kulturës („Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale“ nr.047/22) përcakton se vlerësimi i projekteve të paraqitura në konkurs bëhet nga Komisioni për shpërndarjen e mjeteve, Komisioni i përbër nga kryetari dhe katër anëtarë, i formuar nga eprori i organit kompetent.

Vendimin për shpërndarjen e merr eprori i organit kompetent me propozimin e Komisionit nga neni 9 i këtij Vendimi.

Neni 8 i Vendimit përcakton që projektet e paraqitura në konkurs vlerësohen sipas kriterëve të mëposhtme:

- 1) cilësia artistike dhe rëndësia për zhvillimin kulturor të komunës së Tuzit;
- 2) referencat e zbatuesit;
- 3) kontribut në zhvillimin e vlerave shumëkombëshe dhe multikulturore;
- 4) kontribut në nxitjen e dialogut rajonal dhe nxitjen e zhvillimit të partneritetit;
- 5) afirmimi rajonal i kulturës së komunës së Tuzit;
- 6) kontribut në ruajtjen e traditës dhe trashëgimisë kulturore të Tuzit;
- 7) afirmimi i talenteve premtuese;
- 8) kontribut në afirmimin e krijimtarisë së personave me aftësi të kufizuara;
- 9) realitetin e buxhetit të projektit dhe sigurimin e kushteve për realizimin e tij.

Organi kompetent mund të përcaktojë kriterë të tjera për vlerësimin e projekteve nga një fushë e caktuar e kulturës, në përputhje me ligjin dhe programin kombëtar e lokal të zhvillimit kulturor.

Sekretariati për vetëqeverisje lokale i Komunës së Tuzit shpalli Konkursin publik për bashkëfinancimin e projekteve në fushen e kulturës për vitin 2024. nr. 04-633/24-823/1 më 07.02.2024. dhe e publikoi atë përmes shtypit, mediave, në faqen e Komunës së Tuzit www.tuzi.org.me si dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës së Tuzit.

Në bazë të nenit 9 të Vendimit për bashkëfinancimin e projekteve në fushen e kulturës për vitin 2024. („Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale“ nr.047/22), Kryesuesi i organit kompetent me Vendimin nr. 04-633/24-823/2 nga 06.03.2024. emëroi Komisionin për ndarjen e mjeteve në bazë të konkursit për bashkëfinancim të projekteve nga fusha e kulturës për vitin 2024. për të vlerësuar projektet e paraqitura në konkurs, si dhe për të paraqitur propozimin e Vendimit për shpërndarjen e mjeteve tek eprori i organit kompetent.

Në bazë të nenit 7 të paragrafit 1 të Rregullores së punës së Komisionit, Komisioni shqyrton të gjitha aplikimet e mbrirra në konkurs. Pas vlerësimit të projekteve të paraqitura në konkurs,

komisioni vendosi një listë të aplikimeve që plotësojnë kërkesat e konkursit publik për vitin 2024. Komisioni për shpërndarjen e mjeteve në bazë të konkursit për bashkëfinancimin e projekteve në fushën e kulturës për vitin 2024. shqyrtoi aplikimet e paraqitura dhe duke zbatuar kriteret e përcaktuera me Rregulloren bëri këtë propozim, dhe ja propozoi eprorit të organit kompetent që të marrë Vendim për shpërndarjen e mjeteve.

Pjesëmarrësit e konkursit janë të obliguar që mjetet e marra nga buxheti i Komunës së Tuzit ti përdorin ekskluzivisht për qëllime të miratuera.

Pjesëmarrësit e konkursit të cilët keqpërdorin mjetet për bashkëfinancim të projekteve janë të obliguar të kthejnë shumën totale të mjeteve të paguara nga në kërkesë të Komunës së Tuzit.

Pjesëmarrës në konkurs Veronika Dedvukaj, me vendbanim në Tuz, në bazë të nenit 3 paragrafi 1 të Vendimit për bashkëfinancim të projekteve në fushën e kulturës („Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale“ nr.047/22), nuk plotëson kushtet e përcaktuera në Konkursin publik për bashkëfinancimin e projekteve nga fusha e kulturës për vitin 2024.

NJOFTIM LIGJOR: Pjesëmarrësi në Konkurs ka të drejtë ti paraqesë Komisionit Kundërshtim të arsyetuar për Propozim Vendimin , brenda 8 ditëve nga publikimi i tij.

KRYETARI I KOMISIONIT,



Nikollë Berishaj

Dorëzuar:

-Sekretariatit për vetëqeverisje lokale

-lëndës